

Përmbledhje ekzekutive – Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social – rizhvillimit i djerrinës dhe minierave të mbushura të KEK-ut

Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës synon të mbështesë projektin ‘Gjelbërim i tokës për të ardhmen’, për aktivitete të asistencës teknike për zhvillim të Politikave, Institucioneve dhe Kapaciteteve për Menaxhimin e Tokave të Kontaminuara (Ndotur), si dhe investimet në demonstrimet e pastrimit të tokës së kontaminuar dhe rizhvillimit me mbështetjen financiare të Bankës Botërore.

Ky projekt veçanërisht synon të mbështesë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe autoritetet e Kosovës duke adresuar çështjet kryesore të mjedisit që lidhen me menaxhimin e tokës së kontaminuar përmes:

a) mundësimin të aktiviteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zhvillimin e nevojshëm të kornizës së ligjore / rregullative dhe atij institucional, ngritjen e kapaciteteve, adresimin e mungesës të të dhënave / informacionit, dhe zhvillimin e një plani të veprimit afatgjatë për rehabilitimin dhe rizhvillimin e tokës së kontaminuar në vend, dhe

b) investime në lokacionet të përzgjedhura për të demonstruar praktika të mira ndërkombëtare për rehabilitimin dhe rizhvillimin e tokës së kontaminuar, të cilat njëherit do të shërbejnë për krijimin e një sistemi që mund të përdoret për lokacione të tjera.

Një hapësirë me sipërfaqe prej 104 hektarësh, nën pronësi të KEK-ut, është përzgjedhur si shembull për të demonstruar praktikën e mira ndërkombëtare për rehabilitimin dhe rizhvillimin e tokës së kontaminuar. Kjo zonë e KEK-ut në të cilën është deponuar hiri, është tokë jo-pjellore (shterpë) e cila përbëhet nga zona e djerrinës (përafërsisht 80 ha), zona e mbushur e minierës (përafërsisht 24 ha) dhe karakteristika tjera përgjatë shpatit të djerrinës. KEK-u synon ta rizhvillojë këtë zonë në një hapësirë të hapur publike e cila do të lidhë komunat e Obiliqit, Fushë Kosovës dhe Prishtinës. Strategjia e parapare për rehabilitimin e kësaj zone është zhvilluar në përputhshmëri me Menaxhimin e Qëndrueshëm të Bazuar në Risk të Tokës (MQBRT) e cila ka Fito-parandalim, gjegjësisht aplikimin e një shtrese bimore me veprime të dedikuara për galeritë të mbushura të minierave, tokën dhe ujërat sipërfaqësorë. Rehabilitimi i zonës do të zhvillohet sipas këtyre fazave 1; galeritë e mbushura të minierave dhe pas marrëveshjes përfundimtare me të gjithë pronarët e tokave do të vazhdohet në fazën e 2; zona e djerrinës.

Ky dokument përshkruan detajisht ndikimet dhe reziqet e mundshme mjedisore dhe sociale nga implementimi i projektit dhe efektet e tyre në receptorët kryesorë. Këto ndikime janë në përputhje me fazën e ndërtimit, operimit dhe atë pas operimit.

Nga një këndvështrim mjedisor janë identifikuar vetëm rreziqet negative. Këto ndikime mjedisore kryesisht janë përqendruar në fazën e ndërtimit, ku përdorimi i makinerive të rënda për zhvendosje të dheut do të ketë ndikim në përdorim të energjisë, në zhurmë, vibrim dhe rreziqe nga incidentet. Gjithashtu është moderuar edhe ndikimi gjatë përdorimit të lëndëve të para (rërës dhe zhavorrit).

Gjatë fazës së operimit, parku do të shfaqë edhe efekte pozitive, veçanërisht në biodiversitetin ujëra nëntokësorë dhe në cilësinë e ajrit përreth. Përdorimi i ujit për ujë dhe objektet në afërsi do të

ndikojnë negativisht, dhe një gjë e tillë aplikohet edhe për përdorimin e lëndëve të para, pasi rrugët dhe shtigjet që do të përshkohen do të mirëmbahen duke iu shtuar rërë dhe zhavor. Menaxhimi i mbeturinave mund të ndikojë negativisht, pasi përveç mbeturinave të gjeneruara nga ndërtësat përreth do të ketë edhe mbeurina bimore dhe mbeturinat e gjeneruara nga pastimet e kohëpaskohshme të pellgut. Gjithashtu rreziqet nga dëmet dhe incidentet do të kenë një rritje, kryesisht për shkak të vizitave në zonën punuese. Në fazën postoperative, rreziqet që duhet të menaxhohen janë dheu, zhurma dhe vibrimi si dhe në rreziqet nga incidentet dhe dëmet tjera. Këto rreziqe do të shoqërohen me largimin e objekteve në park por jo edhe largimin e bimësisë.

Tabla 01. Vlerësimi i ndikimit në mjedis

	Ndërtimi	Operimi	Postoperimi
Shfrytëzimi i energjisë	Mesatar	I evitueshëm	I evitueshëm +
Shfrytëzim i ujit	Mesatar	Mesatar	I evitueshëm +
Përdorim i materialeve bazë	Mesatar	Mesatar	Nuk aplikohet
Cilësia e ajrit	I evitueshëm	Mesatar +	I evitueshëm +
Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	I evitueshëm	Mesatar +	I evitueshëm +
Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme	Mesatar	Mesatar	Mesatar
Menaxhimi i dheut	Mesatar	Mesatar +	Mesatar
Zhurna dhe vibrimet	Mesatar	I evitueshëm +	Mesatar
Rreziqet nga dëmet dhe incidentet	Mesatar	Mesatar	Mesatar
Biodiversiteti	I evitueshëm +	Mesatar +	I evitueshëm +
Peisazhi	I evitueshëm +	Mesatar +	I evitueshëm +

Ndikimi kryesor socio-kulturor është marrja e tokës në pronësi, kufizime në përdorim të tokës dhe zhvendosje fizike dhe/ose ekonomike të pavullnetshme e cila edhe me aplikimin e masave zbutëse do të ketë ndikim mesatar. Ndikimet e tjera socio-kulturore do të jenë ndikime më të vogla, për shkak të marrjes së masave për zvoglim të ndikimit. Me aplikimin e duhur të masave zbutëse, nuk parashihet të ketë ndikime të tjera socio-ekonomike apo socio-mjedisore.

Shpalosja e informacionit dhe diskutimi publik janë në zhvillim e sipër. Për shkak të pandemisë globale COVID-19, Qeveria e Kosovës ka pezulluar te gjitha tubimet publike dhe jopublike. Nën presion të kohës dhe në koordinim me Bankën Botërore, grumbullimi i informacionit dhe konsultimet publike do të bëhen duke përdorur mjete virtuale të komunikimit, në mënyrë që të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur çdo kontakt direkt në mes të palëve të interes.

Plani i Menaxhimit Social dhe Mjedisor (PMSM) do të përbëhet nga plane dhe programe që do të adresojnë media, zona dhe aspekte mjedisore specifike. Në fazën e ndërtimit, PMSM përqendrohet kryesisht në aspektet operative të punimeve; zhurmën, vibrimet, cilësinë e ajrit, menaxhimin e mbeturinave dhe rrezikun nga dëmet. Këto veprime do të implementohen nga Kontraktuesi dhe të kontrollohen nga personi përgjegjës. Gjatë fazës operative të mëposhtme, veprimet kryesore të monitorimit përqendrohen në mbeturina, tokë, sipërfaqe dhe ujëra nëntokësore për të siguruar që ndotja e gjeneruar nuk paraqet rrezik dhe mbetjet brenda zonës janë menaxhuar siç duhet. Këto

aktivitete do të mbikqyren nga personi përgjegjës. Aktivitetet në fazën pas operacionit do të jenë përgjegjësi e po këtij personi.

Menaxhimi dhe zvogëlimi i ndikimeve sociale është përqendruar fuqimisht në veprimet e nevojshme për të parandaluar ndikimin në shoqëri për shkak të marrjes në pronësi të tokës dhe zhvendosjes së pavullnetshme. Përgjegjësia për këto veprime varet nga një mori e palëve të interesit, përfshirë këtu huamarrësin dhe komunitat.